



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. 2276/10 Prot.

Pogradec, më 22.05.2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

KRYETARE E KESHILLIT BASHKIAK

E nderuar Kryetare, Znj. Manjola Kamolli

Bashkegjitur po ju dergojme per shqyrtim dhe miratim Projekt Vendimin :

**PËR PËRCAKTIMIN E DISA KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE
DHE SANKSIONIN QË VENDOSET PËR TO NË TERRITORIN E
BASHKISË POGRADEÇ"**

Me respekt,

**KRYETARI
Ilir KHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ___ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, datë ____ . ____ .2024

PËR

**“PËR PËRCAKTIMIN E DISA KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE
DHE SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN E
BASHKISË POGRADEC”**

Në mbështetje pikës 1, germa “a” dhe pika 2 të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 29, pikat 3 dhe 4, nenit 33, pika 1, shkronja “ç”, nenit 54, shkronja “k” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 5, neni 6 shkronja “b”, nenit 10, pika 3, nenit 13, pika 1, shkronja “a”, nenit 14, pika 4, nenit 20, shkronja “dh”, dhe nenit 37, pika 1, të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, nenit 5 pika 1, nenit 10, nenit 12, nenit 23, nenit 29 dhe nenit 38, të ligjit nr.10 431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, nenit 3 pika 32, nenit 18 pika 3, nenit 20 pika 1 dhe nenit 31, pika 12, të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, ligj nr. 50/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Përbashkët Nr.2, datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore”, të ligjit nr.52/2020 për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Vendimit nr.1096, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, udhëzimit nr. 230, datë 20.03.2013, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve dhe detyrave specifike të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore” dhe ligji nr. 10112, datë

9.4.2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", me propozim të kryetarit të Bashkisë;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:



1. Të përcaktojë disa kundrvajtje administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Pogradec sipas lidhjes bashkangjitur.
2. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Policia Bashkiake, Inspektoriati i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Tregjeve, Inspektoriati i Mbrojtjes së Mjedisit.
3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARE

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
INSPEKTORIATET E BASHKISË



Nr. ____ Prot. ____

Pogradec, më ____ . ____ .2024

RELACION

PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT:

“PËR PËRCAKTIMIN E DISA KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË POGRADEC”

E NDERUAR KRYETARE E KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe nisur nga problematikat e hasura gjatë vitit 2023, ndryshimet ligjore të njëpasnjëshme në fusha të ndryshme dhe ekzistenca e disa vendimeve të Këshillit Bashkiak Pogradec ndër vite, vlerësojmë të nevojshëm hartimin e një Vendimi të ri për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionet që do të vendosen për to.

1- HYRJE

Ky vendim ka si synim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt juridik apo individ fizik që ushtrojnë aktivitetin e tyre apo që jetojnë në territorin e Bashkisë Pogradec. Ky vendim përcakton kundërvajtjet administrative për shkeljen e rregullave, normave detyruese, shëndetit publik dhe bashkëjetesës shoqërore në fushën e hapësirës publike, në fushën e qarkullimit rrugor, në fushën e sigurisë, qetësisë, mbrojtjes së mjedisit, si dhe procedurën e konstatimit të kundërvajtjes dhe vendosjes së sanksioneve administrative për to nga sektorët përkatës.

Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike/shtetërore, garantimi dhe zbatimin e rregullave, normave detyruese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë Pogradec, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundërvajtjeve administrative që çojnë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike.

Strukturat konstatuese, Policia Bashkiake dhe Inspektoriatet në varësi të Bashkisë Pogradec, në përmbushje të detyrave funksionale dhe sipas fushës së kompetencave të tyre kanë si mision ruajtjen dhe garantimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore nga kryerja e veprimeve dhe/ose mosveprimeve të kundërligjshme në fushën e infrastrukturës, shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe në fushën e bashkëjetesës dhe mbrojtjes së konsumatorit. Në këtë vendim janë parashikuar kompetencat dhe procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, si dhe zbatimi i tyre.

Aktualisht, strukturat e mësipërme të cilat janë përgjegjëse pranë Bashkisë Pogradec për konstatimin dhe sanksionimin e kundërvajtjeve administrative hasen në vështirësi gjatë ekzekutimit të Vendimeve të Këshillit Bashkiak Pogradec sepse, referuar akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Pogradec sipas rendit kronologjik :

- 1-“Vendimi Nr.12 datë 30.03.2016 “Për rishikimin e vendimit Nr.7 datë 10.02.2016 “Për miratimin e nivelit të gjobave”,
- 2-“Vendimi Nr.62, date 01.06.2020 “Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Pogradec”,
- 3-“Vendimi Nr.106, date 02.12.2021 “Për llojet dhe nivelet e gjobave në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative në Bashkinë Pogradec”,

Këto vendime bien ndesh me njëri –tjetrin dhe me legjislacionin në fuqi , për këtë arsye po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion, me përmbajtje si mësipër.

2- BAZA LIGJORE

- Dispozitat e pikës 1, gërma “a” dhe pika 2 të nenit 113 të Kushtetutës
- Ligji Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”
- Ligji Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,
- Ligji Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,
- Ligji Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”,
- Ligji Nr.10 431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar,
- Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar,
- Ligji Nr. 50/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar,

-Udhëzimi i Përbashkët Nr.2, datë 15.11.2023 "Për nivelin kufi të zhurmës për një miedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore".

-Ligji Nr.52/2020 për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar,

-Ligji Nr. 10465, datë 29.09.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

-Vendimi Nr.1096, datë 28.12.2015 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregulloreve, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike",

-Udhëzimi Nr. 230, datë 20.03.2013, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e funksioneve dhe detyrave specifike të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore"

-Ligji Nr. 10112, datë 9.4.2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit".



3-PROPOZIMI

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Pogradec:

1. Të miratojë kundravajtjet administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Pogradec sipas lidhjes bashkangjitur.
2. Të ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore, Policia Bashkiake, Inspektoriat i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Tregjeve, Inspektoriat i Mbrojtjes së Mjedisit.
3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

Duke shprehur në miratimin e këtij materiali nga ana Jusaj,


Konceptoi: A.Shkëmbi 

J. Ismaili 

K.Çami 

Pranoi: M.Hafesllari 

Miratoi: P.Ziko 

Konfirmoi: D.Babacajli 

KRYETAR
Ilir Xhakolli



KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Ky vendim ka si synim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe normative sjellëse, si dhe standarde të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt juridik, individ dhe fizik që ushtrojnë aktivitetin e tyre apo që jetojnë në Bashkinë Pogradec.

2. Ky vendim përcakton kundërvajtjet administrative për shkeljen e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës së bashkëjetesës shoqërore në fushën e sigurisë publike, qetësisë dhe moralit publik, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe procedurën e konstatimit të kundërvajtjes dhe vendosjes së sanksioneve administrative për to.

3. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike/shtetërore, garantimi dhe zbatimin e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë Pogradec, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundërvajtjeve administrative që cenojnë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Strukturë konstatuese"**, është çdo punonjës i strukturave të Bashkisë Pogradec që ka për detyrë funksionale konstatimin dhe dënimin e kundërvajtjeve administrative, sipas fushës së përgjegjësiqe që mbulon, i cili mund të jetë punonjës i Policisë Bashkiake, Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Tregjeve, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore apo dhe çdo strukture tjetër të ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë.

2. **"Bashkëjetesa shoqërore"** është tërësia e normave që përcaktojnë sjelljen/marrëdhënien e individëve në shoqëri, me qëllim ruajtjen e ekuilibrave të bashkëjetesës, nëpërmjet zbatimit të rregullit social, mbrojtjes së lirisë e të drejtave individuale, sigurisë së jetës dhe veprimtarive të përditshme ekonomike-shoqërore, përfshirë këtu edhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit.

3. **"Funksion i Bashkisë Pogradec"** është fusha e veprimtarisë, për të cilën Bashkia si njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar, lirisht, tërësisht apo në një pjesë, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, sipas parashikimeve të ligjit 139/2015, përfshirë këtu lëshimin e lejeve, licencave dhe autorizimeve përkatëse.

4. **"Hapësirë publike dhe hapësira në bashkëpronësi"**, janë hapësira, si trotuare, rrugë, sheshe, lulishte, parqe, shëtitore, shesh pushime shkallë në pallate, rrugëkalime e mjedise të tjera në përdorim publik, që janë të pacenueshme dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre në

shërbim të përdorimit publik, përveçse përmes dokumenteve të planifikimit, të parashikuara nga ligji.

5. "Veprim" është çdo veprim i caktuar, i natyrës tregtare, ekonomike, profesionale apo çdo veprim tjetër i ngjashëm, apo sjellja e natyrës vetjake e çdo individi/qytetari, i cili kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie, që licencohet apo jo, ose gjatë përdorimit të një të mirë publike, që i nënshtrohet apo jo pajisjes me leje.

6. "Licencë, leje, autorizim" është akti administrativ, që i njeh çdo subjekti apo individi të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, të drejtën të kryejë një apo disa veprime në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

7. "Sanksionet administrative", janë akte administrative që lëshohen ndaj subjekteve dhe individëve nga strukturat konstatuese si rrjedhojë e shkeljes administrative të konstatuara.

Neni 3

Parimet bazë

1. Parimet themelore në bazë të të cilave udhëhiqet Bashkia Pogradec dhe çdo strukturë e saj në veprimtarinë e tyre, janë: Ligjshmëria; Mos diskriminimi; Mbrojtja e të dhënave personale; Paanësia dhe Parimi i drejtësisë; Mbrojtja, garantimi i interesit publik dhe jetës e shëndetit të qytetarëve dhe kontrolli dhe llogaridhënia.

2. Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi të caktuar në territorin e Bashkisë Pogradec, përfshirë këtu miratimet apo autorizimet përkatëse, bëhet vetëm nëse ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullit nuk cenon apo mund të cenojë të jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik, një të mirë publike, objektivat sociale dhe çdo interes tjetër publik dhe qytetar të kësaj natyre;

Neni 4

Misioni dhe detyrat e strukturës konstatuese

1. Strukturat konstatuese, në varësi të Bashkisë Pogradec, në përmbushje të misionit dhe sipas fushës së kompetencave të tyre kanë si mision ruajtjen dhe garantimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore nga kryerja e veprimeve dhe/ose mosveprimeve të kundërligjshme në fushën e infrastrukturës, shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe në fushën e zhvillimit ekonomik vendor dhe sigurisë publike.

2. Çdo strukturë konstatuese, ka si detyrë të monitorojë, kontrollojë e të marrë masat në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për zbatimin e rregulloreve, urdhrave e udhëzimeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak apo Kryetari i Bashkisë, për probleme që lidhen me zbatimin e këtij vendimi apo përmbushjen e funksioneve të Bashkisë Pogradec si njësi e vetëqeverisjes vendore.

Neni 5

Bashkëveprimi me strukturat e tjera

Në përmbushje të misionit dhe realizimit të detyrave, strukturat konstatuese të Bashkisë Pogradec dhe Bashkia Pogradec, sipas rastit dhe nevoja bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë me strukturat dhe institucionet e tjera shtetërore.



KREU II

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 6

1. Veprimtaria e lejuar në territorin e Bashkisë Pogradec

a. Në territorin e Bashkisë Pogradec, përfshirë këtu hapësirat publike dhe ato private, lejohen të kryhen vetëm aktivitete dhe veprimtari që janë në përputhje me qëllimin e kryerjes së tyre, duke respektuar funksionin, kushtet e përdorimit dhe shërbimet e lejuara, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe të përcaktuara dhe të rregulluara në aktet administrative dhe normative të nxjerra nga Bashkia Pogradec apo strukturat përgjegjëse të saj, nëpërmjet lëshimit të lejeve, autorizimeve dhe miratimeve përkatëse nga këto të fundit.

b. Çdo veprimtari apo aktivitet që ushtrohet në territorin e Bashkisë Pogradec, duhet të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse të lëshuara nga ky institucion.

c. Pavarësisht lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga entet publike shtetërore sipas fushës së kompetencave të tyre, çdo veprimtari apo aktivitet që zhvillohet apo synohet të zhvillohet në kundërshtim me këtë vendim, kritereve dhe rregullave të përcaktuara nga Bashkia Pogradec, dënohet administrativisht dhe merren masa deri në mbylljen e aktivitetit që ushtrohet.

2. Zënia në kundërshtim me rregullat të hapësirës publike

a. Ndalohet zënia e hapësirës publike dhe hapësirave mbi apo nën të, në territorin e Bashkisë Pogradec, qoftë edhe përkohësisht, me çfarëdo lloj sendi apo objekti pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo strukturës përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre. 2000-20000 lekë

b. Zënia e hapësirës publike, veprimi apo mosveprimi në kundërshtim me normat detyruese dhe rregullat e miratuara nga Bashkia Pogradec dhe legjislacioni në fuqi, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas këtij vendimi, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për kundërvajtjet administrative.

c. Në rastin e zënies së hapësirës publike në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Bashkia Pogradec apo në rastet kur subjekti e ushtron ose zhvillon aktivitetin në këto hapësira publike pa lejen përkatëse, strukturat konstatuese, veprojnë në përputhje me sanksionet administrative të parashikuara në nenin 15 të këtij vendimi.

ç. Në rastin kur subjekti kundërvajtjes rezulton, se është i padënuar administrativisht për shkeljen e konstatuar, atëherë struktura konstatuese vepron duke vendosur fillimisht dënimin administrativ "Paralajmërimin me shkrim", sipas nenit 15, pika 1, shkronja "a" të këtij vendimi.

d. Në rastin kur, subjekti vijon të kryej aktivitetin apo rezulton të jetë përsëritës i të njëjtës shkelje administrative, struktura konstatuese vendos dënim me gjobë, duke mbajtur në konsideratë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, sipas parashikimeve të këtij vendimi. Subjekti autobus, i cili refuzon të identifikohet apo në rastet kur struktura konstatuese e ka të vështirë e të përmundur identifikimin e tij, ka të drejtën të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit që ka kryer kundërvajtjen administrative.

e. Në rastin e kundërvajtësit, identifikimi i të cilit nuk mund të vërtetohet me anë të dokumenteve identifikuese, Policia Bashkiake liron hapësirën publike dhe vendos e pasqyron në procesverbal bllokimin e mallit dhe ruajtjen e tij për një afat kohor prej 24 orësh nga momenti i konstatimit të kundërvajtjes administrative. Procesverbali/akt konstatimi përpilohet dhe nënshkruhet konform pikës 1 të nenit 13 dhe pikës 1 e 2 të nenit 14 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

f. Me paraqitjen e dokumenteve identifikues dhe kryerjen e procedurës përkatëse administrative, Policia Bashkiake nëpërmjet mbajtjes së procesverbalit përkatës, bën zhbllokimin dhe ja dorëzon mallin e bllokuar subjektit kundërvajtjes.

g. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 7 të këtij neni, Policia Bashkiake, me urdhër të kryeinspektorit ngre një komision të përbërë prej jo më pak se tre punonjës për asgjësimin e mallit të bllokuar. Çdo veprim i komisionit dokumentohet me procesverbalin përkatës të asgjësimit.

h. E njëjta procedurë ndiqet nga Policia Bashkiake edhe në rastin kur kundërvajtësi është i identifikueshëm, por e ushtron aktivitetin dhe zënieën e hapësirës publike në mënyrë të paautorizuar nga strukturat përkatëse.

Neni 7

Kundërvajtjet administrative në fushën e qarkullimit rrugor

1.Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e qarkullimit rrugor, këto veprime:

- a.Qëndrimi i mjeteve në vend-qëndrimet e aprovuara pa lejen e veprimtarisë përkatëse:
2000 - 5000 lekë
- b.Prishja e rradhës së taksive, lëvizja brenda vend-qëndrimit dhe thirrjet për grumbullim udhëtarësh:
2000-5000 lekë
- c.Lëvizja e mjeteve në qytet jashtë skemës dhe jashtë sinjalistikës së përcaktuar nga Bashkia:
2000-5000lekë
- ç.Qarkullimi i mjeteve të tonazhit mbi 3.5 ton në të gjitha rrugët e qytetit përveç unazës (pa autorizim nga Bashkia).
5.000 lekë
- d.Qarkullimi i mjeteve bujqësore në rrugët nacionale me goma të pa pastruara nga balta dhe mallra të tjera që shkaktojnë ndotjen e rrugës.
2000-5000 lekë

e. Mosrespektimi i kushteve të operimit të përcaktuara në licencë për linjat e transportit të udhëtarëve lidhur me itinerarin, oraret, vendqëndrimet dhe frekuencën e linjës përkatëse.

2000-5000 lekë

f. Qarkullimi dhe parkimi i mjeteve të mallit (pa miratimin e Bashkisë) në tregje gjatë ditës nga ora 08.00 deri 17.00 në stinën e dimrit dhe prej orës 07.00 deri 18.00 në stinën e verës.

1000-5000 lekë

g. Parkimi i mjeteve për shitje produktesh nga makina në rrugë dhe sheshe tregu pa miratimin e Bashkisë.

1000-3000 lekë

h. Qarkullimi dhe parkimi në trotuare, lulishte, parqe, hyrje dhe rrugëkalim midis pallatesh, në blloqe banimi i mjeteve të transportit jashtë pikave të caktuara nga Bashkia.

1000-3000 lekë

i. Larja dhe riparimi i mjeteve në ambiente publike si shetitore, rrugë, parqe, sheshe dhe blloqe banimi.

1000-3000 lekë

j. Braktisja e mjeteve të transportit dhe pjesëve të tyre në ambiente publike.

2000-10000 lekë

dhe shpenzimet e heqjes së mjetit.

k. Mospajisja me licensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti për transport udhëtarësh taksitaxi (1+4) dhe (1+8).

5000-10000 lekë

l. Mospajisja me licensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti për transport udhëtarësh me autobus.

10000-20000 lekë

2. Në rastet e kundrvajtjes të pikës 1/h, nga mjete me targa të huaja, do të aplikohet vendosja e një pajisjeje të veçantë me çelës (bllokues) dhe do të hiqet në momentin e kryerjes së pagesës të gjobës.

Neni 8

Kundërvajtjet administrative në fushën e sigurisë

1. Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e sigurisë publike, këto veprime:

a. Zënia e trotuareve, rrugëve dhe rrugëkalimeve që pengojnë lëvizjen për njerëzit dhe automjetet, pa miratimin e strukturës përgjegjëse;

1000-3000 lekë

b. Hedhja e objekteve dhe sendeve të forta, që pengojnë zhvillimin normal të veprimtarive sociale kulturore, rekreative apo promovuese që zhvillohen në hapësirat publike;

2000 lekë

c. Përdorimi i banderolave dhe thirrjeve me përmbajtje fyese apo denigjuese gjatë zhvillimit të aktiviteteve apo veprimtarive sportive, kulturore, fetare, artistike, si dhe gjatë zhvillimit të tubimeve dhe manifestimeve; 1000 lekë

ç. Hyrja e personave në ambientet ku zhvillohen aktivitete publike, rekreative apo promovuese, pa autorizimin e Bashkisë Pogradec; 2000 lekë

d. Zënia e vend parkimeve publike dhe vendeve ku lejohet parkimi në hapësirat pranë blloqeve të banesave me automjete më qëllim ekspozimin/ tregtimin e tyre apo qëllime të tjera biznesi; 2000-5000 lekë

e. Cenimi nëpërmjet bërjes së grafitëve ose shkrimeve, ndotjes me substanca të ndryshme apo me gërvishnja e ndërtesave private e publike apo objekteve të tjera publike, përveç rasteve kur kryhet në kuadër të veprimtarive artistike dhe me miratimin e strukturës përgjegjëse; 1000-3000 lekë

f. Vendosja me ngjitje, kapsim apo çdo mënyrë tjetër, e afisheve ose postareve të ndryshme në ndërtesat private e publike apo në objekte të tjera publike, pa miratimin e strukturës përgjegjëse; 2000 lekë

g. Kryerja e veprimeve apo mosveprimeve, që vënë në rrezik jetën, shëndetin apo pronën e të tjerëve përmes vendosjes pa masa sigurie të vazove të huleve apo çdo send tjetër në parvazet e dritareve, ballkoneve, në terraca apo në çdo pjesë tjetër të mjediseve publike, të përbashkëta apo private; 1000-3000 lekë

h. Qarkullimi me mjete motorike në shëtitore, parqe apo vende pushimi për qytetaret në orët e ndaluara sipas rregullave të përcaktuara nga Bashkia Pogradec; 1000-3000 lekë

i. Tregtimi me pakicë i karburanteve dhe pikat e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombulave të gazit pa autorizim përkatës nga Bashkia. 10000 lekë

j. Vendosja e pengesave të çfarëdo lloji për kufizim shpejtësie të lëvizjes të automjeteve si dhe ndërtimi i objekteve përkujtimore përgjatë rrugës, pa miratimin e organit përgjegjës publik; 2000-5000 lekë

k. Kryerja e çfarëdo veprimtarie tregëtare ambulante në afërsi dhe pranë rrugëve, pa lejen përkatëse. 1000-3000 lekë

l. Mospajisje me leje për shërbime me tavolina jashtë bizneseve private në hapësira publike. 5000-10000 lekë

m. Mospajisje me leje për vendosje reklame të thjeshtë apo elektronike 5000-10000 lekë

Neni 9

Kundërvajtjet administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës

1. Për sa nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës, këto veprime:

- a. Shkaktimi i zhurmave shqetësuese të çfarëdo lloji në ambientet e përbashkëta të banimit; 2000-5000 lekë
- b. Bllokimi dhe dëmtimi i hapësirave të përbashkëta si shkallët, tarracat dhe fasadat e pallateve; 2000-5000 lekë
- c. Preerja dhe çarja e druve të zjarrit në ambjente publike dhe të përbashkëta. 2000 lekë
- ç. Tregtimi i druve të paprera dhe të paçara nga bizneset e licensuara për këtë qëllim. 5000-10000 lekë

Neni 10

Kundërvajtjet administrative për veprime në liqen

1. Për sa nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e mbrojtjes të vijës bregliqenore, këto veprime:

- a. Marrja e rërës nga bregu i liqenit nga individë; 2000-5000 lekë
- b. Marrja e rërës nga bregu i liqenit nga subjekte private; 10000-20000 lekë
- c. Shkarkimi dhe derdhja e ujërave të ndotur (të zeza etj) në lumenj dhe liqen. 5000-10000 lekë
- ç. Hedhja e mbetjeve të ndryshme në bregun e liqenit dhe shtretërit e lumenjve. 5000-10000 lekë
- d. Larja e automjeteve, teshave, tapeteve, kuvertave, qilimave, batanijeve në "Çezmat dhe burimat brenda qytetit të Pogradecit" dhe në vijën bregliqenore të liqenit të Ohrit. 1000-3000 lekë
- e. Parkimi i varkave jashtë vendeve të caktuara nga Bashkia. 1000-3000 lekë
- f. Hyrja e varkave të parregjistruara dhe të pa kolauduara nga organet kompetente. 5000-10000 lekë

Neni 11

Kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit

1. Për sa nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e mjedisit, këto veprime:

- a. Djegia e mbetjeve urbane në kontejnerë (në vend grumbullimin e mbetjeve), në territore private dhe publike. 2000-5000 lekë
- b. Hedhja e mbetjeve familjare, të lokaleve private dhe institucioneve shtetërore jashtë vendeve të caktuara. 2000-5000 lekë
- c. Hedhja e mbetjeve të vëllimshme, mbetjeve të ndërtimit (inerte), në kontenierët e mbetjeve urbane apo në vendet e pa miratuara. 5000-10000 lekë

- d. Hedhja në kontejnerë, i mbetjeve tregëtare dhe të lëngëta, me qese të zgjidhura apo të palidhura mira, i substancave të ngrohta, ndezëse, të rrezikshme për më tepër mbetje të forta apo kafshëve të ngordhura. 2000-5000 lekë
- e. Dërdhja e ujërave të ndotur (ujëra lavamani, ujëra të zaza etj) në trotuare, rrugë, kanale, gradarët e shiut. 2000-5000 lekë
- f. Hedhja e mbetjeve të çastit, ambalazhet, etj. në hapësira publike apo të gjelbra. 1000 lekë
- g. Hedhja e mbetjeve urbane e familjare jashtë kontejnerëve. 1000 lekë
- h. Mungesa e koshit të posaçëm pranë subjektit të shërbimit tregtar. 2000 lekë
- i. Kryerja e selektimit manual, kërkimit apo marrje të mbetjeve nga kontejnerët, etj. nga persona të paautorizuar. 1000 lekë

2. Shkelje të kryera në fushën e ndërtimit dhe të veprimtarive në funksion të saj, të shkaktuar nga subjektet ndërtues/individë, për kryerjen e veprimeve të mëposhtëm:

- a. Ndotje të hapësirës publike jashtë rrethimit të kantierit të ndërtimit, nga inerte apo materiale të tjera ndërtimore. 5000 lekë
- b. Ndërrhyrje në ambientet e brendëshme të apartamenteve apo banesave për punime konstruksioni pa lejen përkatëse të Bashkisë. 3000 lekë

Neni 12

Kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike

Për atë sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e infrastrukturës publike, këto veprime:

1. Ndërrhyrje në rrjetin rrugor, si:

- a. Dëmtim, çarje, dhe bllokim rruge; 2000-5000 lekë
- b. Dëmtim, çarje, trotuari dhe dëmtim bordure; 2000-5000 lekë
- c. Dëmtim, bllokim pusete, kunete, vjedhje kapaku/zgarë pusete. 2000-5000 lekë
- ç. Dëmtimi, levizja nga vendi apo largimi përfundimtar i kontejnerëve dhe koshave të mbeturinave të vendosura nga Bashkia. 5000-10000 lekë

2. Ndërrhyrje në rrjetin elektrik rrugor dhe rrjetin e telefonisë, si:

- a. Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror; 10000-20000 lekë
- b. Dëmtimi i shtyllave apo ndriçuesve; 10000-20000 lekë
- c. Përdorimi i shtyllave si suport mbajtës/mbështetës për montimin e reklamave, kapjen e kabllave elektrike, telefonik, internetit, etj. 10000-20000 lekë
- d. Dëmtimi i traseve kabllore e linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me ose pa leje, si dhe shkalja e shtyllave. 10000-20000 lekë

3. Ndërhyrjet në rrjetin ujësjellësit, si:

- | | |
|--|------------------|
| a. Lidhjet e pamiratuara në tubacion; | 10000-20000 lekë |
| b. Dëmtimi i pusetave; | 10000-20000 lekë |
| c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre, me ose pa leje; | 10000-20000 lekë |

4. Ndërhyrjet në hapësirat publike dhe të gjelbër, si:

- | | |
|---|-----------|
| a. Dëmtim të hapësirës publike dhe të gjelbër, këputje, shkurte apo prerje pemësh, elemente dekorative, vepra arti etj. në këto hapësira; | 5000 lekë |
| b. Mbledhja e farërave, luieve dhe gjetheve të drurëve të gjelbërimit rrugor e parqeve. | 2000 lekë |
| c. Vendosje postera reklamues pa leje, në: fasada, pemë, shtyllë, etj. | 2000 lekë |
| d. Vendosje tabelash, pankartash, banderola pa leje. | 5000 lekë |

Neni 13

Kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, si dhe rregullat e tregut.

1. Për atë që nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative nga pronarët/kujdestarët në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, këto veprime:

a. Të sigurojnë, që në ambientet e përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, kafshët/shpendët e tyre të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët/shpendët e tjera, duke zbatuar detyrimin, që:

- Qeni duhet të mbahet nga pronari/kujdestari, me rrip jo më të gjatë se 1.5 (një pikë pesë) metra.
- Të vendosin maskat mbrojtëse për qentë e racave të rrezikshme: spic, hasky, rotvailer, pitbull, doberman, qeni i sharrit, pastor, kangalli turk, bokser.
- Kujdestari/pronari të mos lëshojë qenin jashtë pronës së tij.
- Të shmangin ndotjen e ambienteve të përbashkëta, në bashkëpronësi dhe hapësirave publike nga kafshët/shpendët e tyre, dhe në rast ndotje, të pastrojnë ambientin pas defektimit.
- Të kryejnë vaksinimin e detyrueshëm vjetor kundër tërbimit.
- Të vaksinonjë dhe kontrollojnë pranë mjekut të klinikës veterinarë, kafshët/shpendët e shoqërimit dhe ato të luksit.
- Të respektojnë mirëqenien e kafshëve/shpendëve të tyre.
- Personat, të cilët mbajnë kafshë/shpendë shtëpiake, të shoqërimit apo të luksit, në banesa individuale apo në bashkëpronësi në zona të urbanizuara, janë të detyruar të mos lejojnë që ato të kryejnë ndotje dhe të shkaktojnë zhurma, duke u bërë shqetësim për pjesëtarët e tjerë të komunitetit.

1000-5000 lekë

b. Mbajtja dhe/ose rritja e kafshëve dhe bagëtive (lope, dele, dhi, derra, kuaj etj), pavarësisht numrit është e ndaluar brenda të gjitha njësive të banimit ose pronës së përbashkët, në qytetin e Pogradecit.

c. Mbajtja dhe/ose rritja e bletëve, lepujve, shpendëve (pula, pata, përdimbo etj), pavarësisht numrit është e ndaluar brenda të gjitha njësive të banimit ose pronës së përbashkët, në qytetin e Pogradecit.

2000-5000 lekë

ç. Kullotja apo qarkullimi i kafshëve blegtorale jo shtëpiake, në mjedise publike të qendrave urbane si: kuaj, lopë, dhen, dhi, derra, shpendë (pula) etj;

2000-5000 lekë

d. Ndërsen kafshët kundër njëra – tjetrës ose përdor kafshën për luftime a shfaqje, që shkaktojnë dhimbje, dëmtime, plagosje ose ngordhjen e tyre.

10000 lekë

2.Mbi rregullat e tregut:

a.Tregëtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale jashtë territorit të përcaktuar nga Bashkia.

1000-3000lekë

b.Tregëtimi i bagëtive të mëdha dhe të imta jashtë vendeve të përcaktuara.

2000-5000 lekë

c. Shitja e produkteve bujqësore jashtë bankinave dhe në tokë.

1000 lek

ç Tregëtimi i peshkut jashtë vendeve të përcaktuara dhe jashtë mjeteve frigoriferike.

1000-3000 lekë

Neni 14

Niveli i gjobave për inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Mos deklarim i personave që kërkojnë akomodim kundrejt pagesës në subjektet me emërtim hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim dhe numri i netëve të qëndruara në hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër.

10000-20000 lekë

KREU III

SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MËNYRA E CAKTIMIT TË TYRE

Neni 15

Sanksionet/Aktet administrative

1. Sanksionet/ Aktet administrative për kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim janë:

a. Paralajmërimi me shkrim/ Akt Konstatimi;

b. Proces verbal për kundërvajtjet administrative, ku sanksionohet masa e gjobës.

2. Sanksioni "paralajmërim me shkrim" është akti i konstatimit është akt administrativ që ka për qëllim këshillimin, paralajmërimin dhe lënien e detyrës për kundërvajtësit, që jepet për një shkeljet të një rëndësie të vogël dhe/apo kur ekzistojnë rrethanat lehtësuese.

3. Përveç sanksionit administrativ të vendosur nga strukturat konstatuese për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim, kundërvajtësit të përfshirë në detyrë dhe konfiskimit të sendeve/mallrave që kanë shërbyer apo që ishin caktuar për të shërbyer në mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuara në këtë vendim.

4. Në rast përsëritjeje të kryerjes të së njëjtës kundërvajtje apo të një kundërvajtje administrative tjetër sipas këtij vendimi apo legjislacionit në fuqi, jepet sanksioni administrativ me gjobë.

Neni 16

Masa e gjobës për kundërvajtjet administrative sipas sektorëve/inspektoriateve

Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative janë të parashikuara në këtë vendim në krah të çdo kundërvajtjeje sipas neneve përkatëse;

1. Ngarkohet **Policia Bashkiake** për vendosjen e masave administrative si më poshtë:

Neni 6, pika 2 "për kundërvajtjet në fushën e rregullave të hapësirës publike",

Neni 7 "për kundërvajtjet në fushën e qarkullimit rrugor",

Neni 8 "për kundërvajtjet në fushën e sigurisë",

Neni 9 "për kundërvajtjet në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës",

Neni 10, pikat a, b, e, f të "për kundërvajtjet administrative për veprime në liqen",

Neni 11 "për kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit", pika 2.

Neni 12 "për kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike".

2. Ngarkohet **Inspektoriati i Mbrojtjes së Mjedisit** pranë Bashkisë Pogradec për zbatimin e :

Neni 10, pikat c, ç, d të "Për kundërvajtjet administrative për veprime në liqen"

Neni 11 "për kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit", pika 1.

3. Ngarkohet **Inspektoriati e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Tregjeve**, për zbatimin e:

Neni 13 "Për kundërvajtjet administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike si dhe rregullat e tregut".

4. Ngarkohet **Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore** për zbatimin e Neni 14.

Neni 17

Shpërblymi i dëmit dhe përllogaritja e tij

1. Nëse struktura konstatuese, konstaton shkaktim dëmi që vjen si pasojë e kundërvajtjes administrative, menjëherë pas vendosjes së gjobës për kundërvajtjen administrative, njofton strukturën përkatëse që është përgjegjëse për përlogaritjen e dëmit të shkaktuar dhe dëmshpërblimin e tij.

2. Struktura përgjegjëse vlerëson masën e dëmit dhe me një akt administrativ, së veje vendos masën dhe mënyrën e shpërblimit të dëmit.

3. Shpërblimi i dëmit kryhet nëpërmjet zëvendësimit apo kthimit në gjendjen e mëparshme të pronës publike, sendit/objektit/hapësirës së dëmtuar ose duke paguar kundërvlefën monetare të dëmit të shkaktuar.

Neni 18

Mënyra e caktimit të dënimit

1. Sanksioni administrativ që zbatohet për çdo shkelje caktohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit në raport me shkeljen e konstatuar, dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative mbi kriteret për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, si dhe dispozitat e këtij vendimi.

2. Nëse personi fizik ose personi juridik ka kryer më shumë se një kundërvajtje nga ato të parashikuara nga ky vendim, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor, dënimi jepet për çdo kundërvajtje.

3. Në rastin kur disa kundërvajtje të kryera nga i njëjti person, konstatohen dhe shqyrtohen nëpërmjet të njëjtit procesverbal, caktohet një dënim me gjobë që përbëhet nga bashkimi i dënimeve me gjobë për secilën nga kundërvajtjet por jo më shumë se dyfishi i masës së gjobës së parashikuar për kundërvajtjen më të rëndë.

4. Nëse në kryerjen e kundërvajtjes kanë marrë pjesë më shumë se një person, dënimi jepet në mënyrë të veçantë për secilin kundërvajtës.

5. Në rast të përsëritjes së shkeljeve të njëjta të kundërvajtjeve në këtë vendim, masa e gjobës do të jetë e dyfishuar.

Neni 19

Rrethanat lehtësuese

1. Lehtësojnë sanksionin administrativ këto rrethana:

a. kundërvajtësi shpreh pendesë për veprimin e kryer;

b. kundërvajtësi ka eliminuar vullnetarisht pasojat e ardhura nga shkelja e kryer, ka kompensuar humbjen ose eliminuar dënimin e kryer;

c. kundërvajtja është kryer për shkak të rrethanave të rënda personale ose familjare;

d. kundërvajtja është kryer nga një grua shtatzënë.

2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënim administrativ me paralajmërim ose dënim administrativ në minimum të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje.

Neni 20

Rrethanat rënduese



1. Rëndojnë sanksionin administrativ këto rrethana:
 - a. kundërvajtësi vazhdon veprimtarinë e paligjshme edhe mbas kërkesës për ta ndërprerë atë;
 - b. kundërvajtja është kryer nga më shumë se një individ apo grup individësh;
 - c. kundërvajtja është kryer gjatë një fatkeqësie natyrore ose rrethana të tjera të gjendjes së jashtëzakonshme;
 - d. kundërvajtja është kryer nën ndikimin e pijeve alkoolike, narkotike apo psikotrope.
2. Kur konstatohet se kundërvajtja administrative është kryer në rrethanat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet dënim me gjobë në një masë afër nivelit maksimal të masës së gjobës së parashikuar për atë kundërvajtje.

KREU IV

KOMPETENCA DHE PROCEDURA E KONSTATIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE ZBATIMI I TYRE

Neni 21

Kompetenca për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore

1. Strukturat konstatuese janë përgjegjëse për konstatimin dhe shqyrtimin e të gjitha kundërvajtjeve të parashikuara në këtë vendim, si edhe të çdo shkeljeje tjetër të përcaktuar nga këshilli bashkiak i Pogradec apo kryetari i Bashkisë së Pogradecit.
2. Kundërvajtjet administrative, sipas këtij vendimi, konstatohen dhe shqyrtohen gjatë veprimtarisë rutinë të ushtrimit të veprimtarisë së tyre ose sipas sinjalizimeve apo ankimeve të individëve dhe qytetarëve të ndryshëm.
3. Gjatë procedurës për konstatimin dhe shqyrtimin e një kundërvajtje administrative, strukturat konstatuese të Bashkisë Pogradec, nëse e shoh të nevojshme, ka të drejtën të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kryerjen e kontrollit të identitetit të personit të dyshuar për kryerjen e kundërvajtjes apo shkeljes së konstatuar.

Neni 22

Procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve

1. Struktura konstatuese konstaton kundërvajtjen dhe e shqyrton atë menjëherë në vendin e kryerjes së saj.

2. Konstatimi dhe shqyrtimi i një kundërvajtje pasqyrohet në procesverbalin e kundërvajtjes, i cili përfshin, dënimin administrativ që jepet dhe sipas rastit shpërblimi dhe përflogaritja e dëmit të shkaktuar. Procesverbali është akt administrativ.

3. Përpara nënshkrimit të procesverbalit të konstatimit dhe vendosjes së gjobës punonjësi konstatues i shpjegon kundërvajtësit shkeljen faktike të kryer, bazën ligjore për konsiderimin e saj si kundërvajtje administrative dhe dënimin administrativ që zbatohet. Kundërvajtësit i jepet mundësia për të paraqitur, aty për aty, komentet dhe shpjegimet përkatëse.

4. Procesverbali, si rregull, hartohet në prani të kundërvajtësit. Ai nënshkruhet nga punonjësi konstatues, kundërvajtësi dhe dëshmitarët e pranishëm, në rast se ka të tillë. Në rastet kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, refuzon të nënshkruajë, nuk mundet të nënshkruajë apo refuzon të marrë procesverbalin, punonjësi konstatues bën një shënim të posaçëm në procesverbal dhe e vërteton këtë fakt nëpërmjet të paktën një dëshmitari.

5. Një kopje e procesverbalit i njoftohet kundërvajtësit nëpërmjet dorëzimit në vend. Në rastet kur kundërvajtësi refuzon të marrë kopjen e procesverbalit, ai konsiderohet i njoftuar. Në rastet kur kundërvajtësi nuk është i pranishëm, procesverbali njoftohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Dëshmitar, mund të jetë çdo person fizik me zotësi të plotë për të vepruar, përfshirë këtu edhe një agjent tjetër konstatues.

Neni 23

Procesverbali dhe baza e të dhënave

1. Modeli i procesverbalit për kundërvajtjen administrative dhe procesverbali për shpërblimin e dëmit miratohen nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjen administrative.

2. Kryetari i Bashkisë, miraton rregullat për krijimin, administrimin të bazës së të dhënave për kundërvajtjet administrative, ku përfshihen, dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave dhe nivelin e aksesit në këtë bazë të dhënash.

Neni 24

Ankimi administrativ

1. Kundër procesverbalit nëpërmjet të cilit është vendosur sanksioni administrativ me gjobë mund të paraqitet ankimi administrativ në Komisionin e Apelit pranë Bashkisë Pogradec, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe aktet nënligjore të nxjerra nga këshilli bashkiak Pogradec apo kryetari i bashkisë Pogradec.

2. Në rast lënies në fuqi të dënimin, gjoba paguhet në afatin e caktuar në vendimin e komisionit të apelit, apo në mungesë të një parashikimi të tillë në çastin kur vendimi hyn në fuqi.

Neni 25

Zbatimi vulnetar

1. Gjobat paguhen vullnetarisht brenda 10 ditëve nga data kur ai bëhet gjoba bëhet e ekzekutueshme.
2. Pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, zbatohet një kamatëvonesë prej 2% (dy për qind) mbi masën e gjobës, për çdo ditë vonesë. Shuma totale e kamatëvonesave nuk mund të tejkalojë masën e gjobës.
3. Nëse gjoba paguhet vullnetarisht brenda 5 ditëve nga data kur ai bëhet i ekzekutueshëm sipas Kodit të Procedurës Administrative, aplikohet një zbritje prej 20% të masës të gjobës.
4. Pagesa vullnetare e gjobës dhe ose/kamatëvonesa bëhet në llogarinë bankare të strukturës që ka vendosur sanksionin administrativ.

Neni 26

Ekzekutimi i dënimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë apo shpërblimin e dëmit, i vendosur nga strukturat kontestuese në zbatim të këtij vendimi përbëjnë titull ekzekutiv dhe ekzekutimi i tyre kryhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Në rast se nga aktet ligjore e nënligjore nuk parashikohet ndryshe, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është struktura përgjegjëse për arkëtimin dhe ekzekutimin e detyrueshëm të tyre.
3. Të ardhurat nga gjobat dhe për kundërvajtjet dhe shpërblimin e dëmeve të parashikuara nga ky vendim, kalojnë tërësisht në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Neni 27

Procedurat e veprimit në rastin e kundërvajtjeve të tjera

Kur struktura konstatuese krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim ose mosveprim i një personi fizik ose juridik, përbën një kundërvajtje administrative, konstatimi dhe shqyrtimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i riparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtjesit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 28

Dispozita kalimtare

Të gjithë pikat e Nenit 7 "Kundërvajtjet administrative në fushën e qarkullimit rrugor", do të aplikohen nga Policia Bashkiake deri në momentin e vendosjes së sistemit elektronik të vjeljes së gjobave nga Bashkia Pogradec.

Neni 29

Urdhrat dhe vendimet

Ngarkohet kryetari i Bashkisë Pogradec që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratoj urdhrat dhe vendimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi. Për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Pogradec miraton formularët përkatës që duhet të përdoren nga strukturat konstatuese të Bashkisë.



Neni 30

Shfuqizime

Vendimi Nr.12 datë 30.03.2016 "Për rishikimin e vendimit Nr.7 datë 10.02.2016 "Për miratimin e nivelit të gjobave", Vendimi Nr.62, date 01.06.2020 "Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Pogradec", Vendimi Nr.106, datë 02.12.2021 "Për llojet dhe nivelet e gjobave në rastet e shkeljeve dhe kundravajtjeve administrative në Bashkinë Pogradec", si edhe çdo vendim tjetër që bie ndesh me parashikimet e këtij vendimi, shfuqizohet.

Neni 31

Strukturat që ngarkohen me zbatimin e vendimit

Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore, Policia Bashkiake, Inspektoriat i Mbrojtjes së Mjedisit, Inspektoriat i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Tregjeve si edhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.